



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr.01

Prishtinë, më 6.10.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu, Abdyl Salihu, Nezir Çoçaj, Verica Qeraniq dhe Albulena Balaj-Halimi anëtarë.

**Përfaqësues të tjerë:** Rron Gjinovci-ORCA, Sanije Berisha-OSCE dhe mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.**

**Për këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

**1. Konstituimi i Komisionit.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Konstituimi i Komisionit.**

Kryetari i Komisionit Ismajl Kurteshi, në fillim të mbledhjes tha se takimi ka më tepër karakter njohës me anëtarët e Komisionit si dhe me veprimtarinë e Komisionit.

Si kryetar i Komisionit, ai u zotua se dallimet në aspektin politik nuk do të ndikojnë në punën e Komisionit, ashtu sikurse kemi vepruar edhe në periudhën e kaluar legjislativë. Bashkërisht me anëtarët e komisionit do të kontribuojmë në shqyrtimin e projektligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe realizimit të detyrave në fushat që i mbulon Komisioni.

Si çështje me rëndësi theksoi hartimin e planit të punës për këtë vit kalendarik, duke marrë për bazë programin legjislativ të Qeverisë.

**Myfera Shiniq**, tha se ky është mandati i dytë në këtë Komision dhe premtoi bashkëpunim me anëtarët e komisionit në këtë legjislativë.

**Adem Mikullovc**, theksoi se gjatë viteve të 90-ta ka qenë pjesë përbërëse e Kuvendit të atëhershëm. Ai tha se personalisht ka vërejtje sa i përket çështjeve që mbulon Komisioni, konkretisht kërkoi që fusha e mediave të jetë pjesë përbërëse e këtij Komisioni ndërsa fusha e sportit të jetë në kuadër të Komisionit për shëndetësi.

**Fidan Rekalju**, tha se do ta jap kontributin e tij në çështjet që mbulon Komisioni, veçanërisht në çështjet që kanë të bëjnë me rininë.

**Arbërie Nagavci**, në diskutimin e saj tha se duke e pasur parasysh përvojën në fushën e arsimit si dhe rëndësinë e sistemit arsimor në përgjithësi, do të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes bashkërisht me anëtarët e tjerë të Komisionit.

**Valentina Bunjaku-Rexhepi**, tha se do të angazhohet dhe të jap kontributin e saj në fushat që mbulon Komisioni.

**Albulena Balaj-Halimaj**, në diskutimin e saj tha se do të bashkëpunojë me të gjithë anëtarët në të gjitha çështjet që mbulon Komisioni.

**Verica Qeraniq**, tha se do të angazhohet që bashkërisht me anëtarët e tjerë të jap kontributin në punën e Komisionit.

**Abdyl Salihu**, tha se fushat që i mbulon Komisioni kërkojnë angazhim dhe bashkëpunim, i cili shpreston se nuk do të mungojë me qëllim që të kontribuohet në përmirësimin e sistemit arsimor.

**Nezir Çoçaj**, në diskutimin e tij shprehi gatishmërinë për të dhënë kontributin e tij në fushat që mbulon Komisioni, veçanërisht në fushën e arsimit. Lidhur me këtë ai tha se duhet të fokusohemi në aspektin profesional ndërsa çështjet politike ti adresojmë në seancë. Sa i përket fushës së arsimit ai propozoi që në një nga mbledhjet e radhës të ftohet ministri i Arsimit me qëllim të diskutimit lidhur me disa vendime të nxjerra kohët e fundit.

**Teuta Haxhiu**, tha se bashkëpunimi në Komision duhet të jetë prioritet i të gjithë anëtarëve të Komisionit pavarësisht bindjeve politike, e njëjta frymë ka dominuar edhe në legjislaturën e kaluar. Sa i përket fushës së arsimit ajo propozoi që të ftohet ministri i Arsimit, me ç'rast do të njoftojë për disa vendime dhe Udhëzime Administrative të nxjerra nga ish- ministri si dhe lidhur me Projektligjin për mësimdhënësit e viteve të 90-ta. Gjithashtu, Haxhiu propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i Kulturës me qëllim që të na njoftojë lidhur me programin e punës së MKRS-së.

**Ismajl Kurteshi**, tha se bazuar në programin legjislativ të Qeverisë, të bëjmë një plan të punës për këtë vit dhe i ftoj anëtarët e Komisionit që të japin propozimet e tyre për plotësimin e planit të punës me aktivitetet që vlerësojnë se duhet të përfshihen në të.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku do të diskutohet rreth programit të punës së kësaj ministrie.

Po ashtu, anëtarët e Komisionit u pajtuan që mbledhjet e rregullta të mbahen ditën e martë, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

***E përgatiti:***  
***Stafi mbështetës i Komisionit***

Kryetari i Komisionit,  
-----  
Ismajl Kurteshi